

D.4. Relatimi
22.09.20



KUVENDI
NR 2365 DATE 22.09.20

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

Nr ____ prot

Tiranë, më __/9/ .2020

Lënda:

Depozitim nisme legislative

Drejtuar :

Z. GRAMOZ RUÇI

Kryetar i Kuvendit të Shqipërisë

I nderuar Z. Kryetar i Kuvendit,

Bazuar në nenin 81, pika 1, të Kushtetutës dhe në nenin 68 të Rregullores së Kuvendit, në cilësinë e deputetit të Kuvendit të Shqipërisë, Ju dorëzojmë për shqyrtim dhe miratim në Kuvend nismën ligjore “Për një ndryshim në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”.

Bashkëlidhur janë teksti i nismës dhe relacioni shoqërues i tij.

Deputeti propozues

Klotilda Bushka



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

PROJEKTLIGJ

Nr. ____ / 2020

**“PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 96/2016
PËR STATUSIN E GJYQTARËVE DHE PROKURORËVE NË REPUBLIKËN E
SHQIPËRISË”, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 81 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e një deputeti,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Në nenin 77, pas shkronjës “c” shtohet shkronja “c/1” me këtë përmbajtje:

“c/1) dosjet e hetimit ose, sipas rastit, të gjyimit për krimet që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve që Kodi Penal parashikon në minimum dënimin me jo me pak se një vit burg, duke përfshirë, për dosjet gjyqësore, edhe regjistrimet e seancave me mjete audio ose video, të cilat janë hetuar ose gjykuar nga magjistrati.”

Neni 2

Në nenin 82 shtohet shkronja “d” shtohet shkronja “d/1” me këtë përmbajtje:

“d/1) për kryetarin e prokurorisë, dosjet e hetimit për krimet që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve që Kodi Penal parashikon në minimum dënimin me jo me pak se një vit burg, të cilat janë hetuar nën drejtimin e tij.”

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Gramoz RUÇI